



Armë, municione dhe 40 mijë euro, kapet 'mat' pronari i lokalit në Korçë

01/09/2019 14:05





Një 54-vjeçar korçar është arrestuar nga policia, pasi është kapur me armë zjarri, municione luftarake pa leje dhe një sasi prej 40 mijë eurosh të pajustificuara.



Në pranga ka rënë shtetasi D. Ç., banues në fshatin Dishnicë, i cili mbante në lokalit dhe banesën e tij një pistoletë me mulli, fishekë dhe 40 mijë euro.

Njoftimi i policisë:

Arrestohet në flagrancë një shtetas, i cili posedonte armë zjarri, municion luftarak pa leje, si edhe një sasi të konsiderueshme eurosh të pajustificuara.

Specialistët për Hetimin e Krimin Ekonomik Financiar, në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit: D.Ç., 54 vjeç, banues në fshatin Dishnicë, Korçë.

Nga informacione të siguruar në rrugë policore, si edhe nga kontrolli që shërbimet e Komisarariatit të Policisë Korçë ushtruan në lokalit dhe më pas në banesën e tij, iu gjetën e sekuestruan në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri tip pistoletë me mulli, me 6 fishekë luftarakë pa leje, si edhe rreth 40 000 Euro, sasi monetare kjo e pajustificuar nga 54-vjeçari.

Shtetas D.Ç., dyshohet të ketë konsumuar elementë të veprave penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë për veprime të mëtejshme.
